

Kombetarja arrin ne Lens

nga Administrator

E premte, 10 Qershor 2016 12:17



Dje mbasdite ekipi ka zhvilluar seancen e vetme stervitore, duke u perqendruar ne ushtrime teknike. Gjithashtu eshte zhvilluar si zakonisht konferenca per shtyp, ku kane qene te pranishem Basha dhe Kaçe. Lojtaret jane shprehur se jane gati per ndeshjen e pare si edhe jane te motivuar per ta kaluar me sukses kete ndeshje. Gjithashtu ato kane shprehur gatishmerine per te dhene kontributin e tyre pavaresisht se do ta fillojne ndeshjen si titullare. Sot paradite ekipi i Shqiperise eshte nisur drejt qytetit te Lens, ku neser ne oren 15:00 do te debutoje ne kampionatin European France 2016. Ekipi ka arritur ne qytetin e Lens rreth ores 13:00. Ne oren 17:45 do te mbahet konferenca per shtyp si edhe ne oren 18:30 ekipi do te zhvilloje stervitjen ne stadiumin Bolleart-Delilis te Lens.